



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Datë: 29.12.2023
02 Nr.020/01-32247/23

PROCESVERBAL

Takimi II (i dytë) Publik me qytetarë për vitin 2023
I mbajtur më 21.12.2023, e enjte, duke filluar nga ora 11:00
VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash

Njoftimi për këtë Takim Publik është publikuar më 04.12.2023:

Në uebfaqe zyrtare të Komunës:

Shqip: <https://kk.rks.gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/12/Takimi%20II-te-publik-2023.pdf>

Boshnjakisht: https://kk.rks.gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/12/II_Jarri_Skup_2023.pdf

Në Facebook-un zyrtar:

Shqip: https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02LJL6p4b6ePte9zc3msRkii12w94r8QKwJgdV1AoCMI1W9khu8jYVnisubzsj8FXA_gf&id=100066575766996

Boshnjakisht: https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02LJL6p4b6ePte9zc3msRkii12w94r8QKwJgdV1AoCMI1W9khu8jYVnisubzsj8FXA_gf&id=100066575766996

Në këtë takim nga Kabineti i Kryetarit të Komunës morën pjesë:

1. Bexhet Xheladini - Kryetar
2. Fejsal Halilovic – Nënkryetar për Komunitete
3. Zeni Krasniqi – Drejtor i DKA-së
4. Qamil Kolloni – Drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim
5. Vetim Ramadani – Drejtor i Administratës
6. Liridona Misinaj – Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport
7. Behar Brenoli – Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
8. Bean Hadziasan – Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit
9. Uzair Hamza – Shef i Zyrës për Komunitete dhe Kthim
10. Lindita Kozmaqi Piraj – Zyrtare për Barazi Gjinore

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 020/01-32247/23
29.12.2023
Dragash - Dragaš

11. Veton Halili – Shef i Kabinetit
12. Fari Kolloni – Zyrtar për Informim

Pjesëmarrës në këtë takim kanë qenë gjithsej 54 persona, të cilët janë nënshkruar në Listën e pjesëmarrësve. Prej tyre kanë qenë:

1. Femra: 19
2. Meshkuj: 35

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës së Dragashit Bexhet Xheladini.

Bexhet Xheladini, në cilësinë e kryetarit të Komunës, i përshëndeti dhe i falënderoi për pjesëmarrje të gjithë qytetarët. Ai tha se në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës, Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike, kryetari i komunës është i obliguar që dy herë në vit të mbajë debat publik me qytetarët për buxhetin e Komunës së Dragashit. Ky është debati i dytë publik për këtë vit, andaj më lejoni që në pika të shkurtëra të bëj një prezantim të buxhetit të Komunës sonë, shpenzimeve, investimeve kapitale dhe kategorive të tjera të buxhetit. Buxheti i Komunës së Dragashit, siç po e shihni, është **11,301,196.57**, dhe në tabelë shihen ndarjet e buxhetit sipas kategorive dhe sipas drejtorateve:

1. Paga dhe Shtesa - **5,231,054.79**
2. Mallra dhe Shërbime - **1,268,741.33**
3. Shpenzime Komunale - **150,000.00**
4. Subvencione dhe Transfere - **412,846.98**
5. Investime Kapitale - **4,238,553.47**

Kryetari Xheladini më pas prezantoi në mënyrë të detajuar të gjitha projektet e investimeve kapitale për vitin 2023, nëpër të gjitha fshatrat dhe qytezën e Dragashit.

Bexhet Xheladini: Të nderuar qytetarë, ju falemnderit për vëmendjen tuaj! Unë nuk dua ta zgjas më shumë këtë debat. Tash e keni fjalën ju. Ata të cilët duan të bëjnë pyetje, të cilët duan të diskutojnë, mund të dalin në foltore, ta marrin fjalën.

Nesim Hodža (Radio Bambus): I nderuar Kryetar, ju njoh prej kohësh, keni qenë në krye të ekzekutivit, keni qenë shumë trim dhe dinjitoz kur ju ofruan të firmosni uzurpimin, por nuk e pranuat. Sa herë që të shoh, ai imazh më kthehet përsëri. Flasim për uzurpimin që tani është në duart e privatëve, e ai është objekti i qendrës së komunitetit në qendër të fshatit Restelicë. Faleminderit z.Kryetar, faleminderit z.Vetim Ramadani, faleminderit z.Nuhija, të cilit ngritën makineritë dhe shtruan rrugën në Strezimir. Faleminderit z.Kryetar, faleminderit z.Vetim Ramadani, drejtori Bean Hadziasan, i cili nuk lejoi të dështonte projekti i vendosjes së tubave në vendin e quajtur Ravnista. Dhe nuk lejuat uzurpimin atje. Megjithatë, disa projekte realizohen sipas dëshirës. Në vend të projektit Kaljovska Vodenica, ambulants, keni kubëzuar rrugën që të çon në shtëpinë e Adem Hoxhës. Disa punime, kubëzime nuk janë përfunduar, ndoshta për shkak të kompanisë jo të përgjegjshme. Kemi punonjës policie, mjekë dhe teknikë që punojnë në ambulancat tona, marrin rroga nga buxheti ynë, por nuk janë të integruar. Në fshatin Restelicë, papritmas kemi një proces të ndryshimit të Këshillit të fshatit me mbështetjen tuaj, a është e saktë?

Bexhet Xheladini: Atëherë unë po kaloj drejtpërdrejt në përgjigje të pyetjeve tuaja. Sa i përket takimit që e keni mbajtur për ndërrimin e Këshillit të fshatit, askush nuk është konsultuar me mua. Unë e kam pa përmes një lajmi ti që e ke qit në Facebook. Askush nuk ka ardhë te unë me u lajmëruar, me marrë leje me më njoftue që ka takim, dhe unë nuk përzihem, si kryetar i Komunës, në organizimet e fshatrave, kënd ata e zgjedhin udhëheqës, kënd e zgjedhin kryetar, kënd e zgjedhin këshill të fshatit. Nëse po qarkullon ky lajm në Restelicë, është gënjeshtër. Sa i përket kubëzimit të disa rrugëve në fshatin Restelicë, është e vërtetë që një kompani e papërgjegjshme e ka fitue tenderin, mirëpo Zyra jonë e prokurimit punon në bazë të ligjit, dhe çdo herë, kompania e cila i plotëson kushtet ligjore dhe e ka çmimin më të ulët se kompanitë tjera, çdo herë Zyra e prokurimit ia jep tenderin kompanisë e cila e ka çmimin më të ulët. Dhe, në rastin në fjalë, kjo kompani e ka pas çmimin më të ulët, mirëpo ka qëllue kompani e papërgjegjshme dhe i ka zhague punët deri në dhjetor. Unë shpresoj që pjesën më të madhe të punëve ai do ta kryejë, deri më datën 27 ka ende kohë, dhe ai do të paguhet vetëm për ato punë që i ka kryer. Faleminderit! Ka dikush tjetër ndonjë pyetje? Ju kisha lut me u orientue në debatin publik për buxhetin. Për çështje tjera mujm na me pas edhe takime tjera, përndryshe, orientohuni ju lutem në debatin publik për buxhetin.

Hajredin Brenoli, qytetar: Sa i përket projekteve të realizuara nga kjo Komunë, shoh që Komuna në shumicën e rasteve përqendrohet në ndërtimin e rrugëve, kubëzime, ndërtimin e murit mbajtës, madje edhe në disa vende ku nuk është aspak e nevojshme, si në fshatin Krushevë, ku lumi është

plotësisht i vdekur. Nëse dikush nga pushteti ekzekutiv bën plane në emër të qytetarëve, duhet të konsultohen qytetarët për këtë çështje. Pyes me këtë rast, në cilin takim është konsultuar dikush me qytetarët e Krushevës për projektet e fshatit Krushevë, nuk ka procesverbal për këtë çështje.

Bexhet Xheladini: z.Hajredin, të kisha lut të diskutosh për debatin publik për buxhetin.

Sa i përket vërejtjeve tuaja, unë vitin e kaluar kam qenë në një takim me qytetarë, me ju, dhe jemi marrë vesh që aty të bëhen disa ndryshime dhe organizime të fshatit. Nuk e di a janë bërë a jo, mirëpo investimet kapitale që janë bërë në fshatin tuaj, të gjitha kanë ardhë me kërkesë të Këshillit të fshatit. Çdo investim që bëhet, edhe në fshatrat tjerë, bëhet me kërkesë të këshillave të fshatrave.

Para se ta përfundoj këtë takim, pasi tjerë nuk ka të paraqitur për ta marrë fjalën, unë këtu në fillim të fjalës thashë se buxheti i Komunës së Dragashit për investimet kapitale për vitin 2023 është mbi 4 milionë euro. Këto janë investime nga Granti. Unë këtu në këtë debat nuk i kam përfshirë edhe investimet që i kemi bërë në bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës. Shfrytëzoj rastin që të falënderoj zv/ministrin Hysen Durmishi, i cili vitin e kaluar, bashkë me mu, kemi nënshkruar disa memorandume për disa rrugë në Komuënn tonë. Po i përmendi: Asfaltimi i rrugës Bresanë – Bjeshkë është investim ekskluziv i Ministrisë së Infrastrukturës; asfaltimi i rrugës Kapre – Rrenc është me bashkëfinancim; asfaltimi i rrugës për Strazimir është me bashkëfinancim. Gjithashtu, këtë vit kam nënshkruar edhe një memorandum me Ministrin Hysen Durmishi, për asfaltimin e Stacionit të Autobusëve, mirëpo për shkak të borës ky investim nuk ka mund të realizohet këtë vit, po shpresojmë se do të realizohet vitin e ardhshëm. Gjithashtu, është një investim rreth 2.5 milionë euro, janë ndarë mjete nga Qeveria e Kosovës, për asfaltimin e rrugës Kërstec – Pakishtë. Shfrytëzoj rastin ta falënderoj edhe Ministrin Fikrim Damka, i cili këtë vit ka ndarë 60 mijë euro për bashkëfinancimin e asfaltimit të rrugës Dragash – Stadium i qytetit.

Unë me kaq po e përfundoj këtë takim. Faleminderit për pjesëmarrje!

SHTOJCË: *Lista e pjesëmarrësve në Takim Publik dhe fotografitë!*



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo/Republic of Kosovo
 Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



LISTA

E pjesëmarrësve në TAKIMIN E II-të PUBLIK 2023
 Lista učesnika na II Javni Skup 2023

Data/Datum: 21.12.2023

Nr. Br.	Emri dhe Mbiemri Ime i Prezime	Nga/ Od	Nënshkrimi Potpis
1	LIRIDONA HESINJA	DKRS	[Signature]
2	Kaltrina Krasniqi	DAA	[Signature]
3	Clervete Emin	K. Komuna	[Signature]
4	Zahire Ahmeti	K. Komuna	[Signature]
5	Berolise Ibrahimaj	LGJC	[Signature]
6	Allfane Shushnjaku	DKA	[Signature]
7	Behar Rami	K.R.U. - Dragash	[Signature]
8	Qamir Ralton	DKRS	[Signature]
9	Dren Myrtezani	Komuna Dragash	[Signature]
10	Emrhit Rinoj	AKMF - Dragash	[Signature]
11	Çerkira Zajmal	Shajme	[Signature]
12	Gamir Mehmeti	AKMF Dragash	[Signature]
13	Hanim Jajti	AKMF DRAGASH	[Signature]
14	Artan Lulaj	DELEGAT	[Signature]
15	DIJAN HAJ	BRUT	[Signature]
16	FITIN SPATHU	DRAGASH	[Signature]
17	Amir Dautolani	AKMF	[Signature]
18	Mehmet Gjogji	Asambleja Kom. Dragash	[Signature]
19	Mehmet Ahmeti	Shajme	[Signature]
20	HILH HAJI	Kapaa	[Signature]
21	Shida Brenoli	Krusevopaktit	[Signature]
22	Suna Bendi	Krushevo Paktit	[Signature]
23	Azra Ahmeti	Shajme	[Signature]
24	Greca Hasani	QJQ - Miro	[Signature]
25	ELISA RASHITI	QJQ ANKO	[Signature]
26	JETON GENCALI	QJQ MUKO	[Signature]
27	SIHANA RAMADANI	AKMF - DRAGASH	[Signature]
28	Merita Bojxhi	AKMF - Dragash	[Signature]
29	Mirina Ujarezi	AKMF - Dragash	[Signature]
30	Ben Habirson	BRAD	[Signature]
31	Behar Brenoli	Krushevo	[Signature]
32	AKMF KATI	Krushevo	[Signature]

REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 Komuna e Dragashit
 Opština Dragaš

02 Nr. Br. 020/01-32247/23
 21.12.20 23
 Dragash - Dragaš

33	Kyrypylyy Eremida	KURGUO	Li Kuro
34	Jen Krasnaja	DNA	Thromaj
35	Doplan Fetlevi	KUK	Thumko.
36	ANELINA DAUTI	Dragas	A.D
37	Zherahia Bajaxhe	PPAR	Dr. J.
38	LINDA KOLMAI PIRA	Plave	Dr. J.
39	Sebahate Sylejmani Shala	Pitren	Dr. J.
40	Violca Qofteshi	Bellobrad	Dr. J.
41	KERIM LATIFI	BIAC	Dr. J.
42	BRENDI BERISHA	BUCE	Dr. J.
43	Agon Baxhaku	Bellobrad	Dr. J.
44	Faton Nafizi	KUK	Dr. J.
45	REHAR SELMANI	KUK	Dr. J.
46	Enall Gani	OSCE	Dr. J.
47	YU DAFLESHI	BELLOBRAD	Dr. J.
48	Armend Sylejmani	QPS	Dr. J.
49	MUSO CUFETA		Dr. J.
50	FARI KOLLOVA	KOSOVA	Dr. J.
51	SUND TO SUND	DAPAR	Dr. J.
52	Shqipëri Përon	Opuz	Dr. J.
53	Begin Beyaz	Bellobrad	Dr. J.
54	Veton Halili	Zaplixhe	Dr. J.
55			
56			
57			
58			
59			
60			
61			
62			
63			
64			
65			
66			
67			
68			
69			
70			
71			
72			
73			
74			
75			
76			
77			



